



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:046170

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05521998

C.nr.802/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve A.H.nga fshati R., Komuna V. dhe H.b.nga fshati N., Komuna V., të përfaqësuara nga L.M., avokat në F., kundër të paditurës Komuna e V. -Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi sipas inflacionit, vlera e kontestit 390.68 €, jashtë seancës, me datë 26.03.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Apropohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëseve A.H.nga fshati R., Komuna V. dhe H.b.nga fshati N., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëseve:

A.H., në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën 01.08.2022 deri më 22.11.2022, për 4 muaj, t'ia paguajë shumën **195.34 €** dhe

A.B., në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën 01.08.2022 deri më 22.11.2022, për 4 muaj, t'ia paguajë shumën **182.35 €**.

Të gjitha me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses H.b.në emër të inflacionit, e kërkuar për periudhën 01.08.2022 deri më 22.11.2022, në shumën 12.99 €.

III. Detyrohet e paditura që paditëseve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën 138 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor ndërsa, refuzohet shuma 135 € e kërkuar në emër të përfaqësimit në seancë gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 06.02.2024, në këtë gjykatë kanë ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 390.68 €.

I autorizuari i paditëseve, në padi ka theksuar se të dy paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht paditësja Arlinda, në shkollën “Halil Alidema” në fshatin Pozheran si dhe paditësja Hanmije, në shkollën “Skënder Emërllahu” në fshatin Ramjan, Komuna V.. Nga gjykata kanë kërkuar që e paditura, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën 01.08.2022 deri më 22.11.2022, për 4 muaj, të dy paditëseve t’ia paguajë nga 195.34 €, në shumën e përgjithshme 390.68 €. Bazën ligjore të kërkesëpadiësë e kanë mbështetur në nenin 35, paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t 14.04.2017 dhe 22.01.2021. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar, shumën 156 € për përpilimin e padisë, 21 € për taksën gjyqësore për padi dhe 135 € për përfaqësim në seancë gjyqësore, në shumën e përgjithshme 260 €.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjithashtu, e paditura është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditëseve ashtu që, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e tyre të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadija e paditëseve si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiësë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadija”.

Gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditëseve janë të punësuar tek e paditura, se paditësja Arlinda, pagën bazë e ka 421 € dhe paditësja Hanmije, pagën bazë e ka 393 € ndërsa, se shkalla e inflacionit për V.n 2022 është 11.6 %, fakt i provuar

Numri i lëndës: 2024:046170
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05521998

nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës. Duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, gjykata, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Pasi e paditura e ka kontestuar bazën ligjore të kërkesëpadisë dhe është thirrur në parashkrim të kërkesës, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor sepse, themelësia e kërkesëpadisë bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021; nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”. Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e V.t 2017 aplikohen edhe për periudhën Janar 2019-20.01.2021, ndërsa pas kësaj date ato të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022.

Sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023, të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023, të datës 05.10.2023, dispozitat e KKAK-së për V.n 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017-21.01.2021 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022.

Gjykata refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimit pasi që në padi është bërë një gabim, ashtu që është llogaritur shkalla e inflacionit me pagën bazë 421 € për paditësen Hanmije, ndërsa realisht paga bazë e saj është 393 € (provë, lista e pagave EM0057660 në emër të paditëses).

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” andaj, gjykata aprovoi të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimeve se nuk ka pasë inflacion të theksuar, sipas nenit 35 të Kontratës mjafton vetëm konstatimi se ka pasur inflacion. Gjithahtu, sa i përket asaj se e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditëseve, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëseve është e afatshme përkatësisht, kërkesa ka të bëjë me periudhën nga data 01.08.2022-22.11.2022 ndërsa, paditëset kanë ushtruar padi me datë 06.02.2024 pra, brenda afatit të përcaktuar kohor prej 3 viteve (neni 87 i Ligjit të Punës).

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së ndërsa, për shpenzimet e procedurës në nenin 452.1 lidhur me procedurat e kontesteve me vlerë të vogël, të përcaktuar

Numri i lëndës: 2024:046170
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05521998

në nenin 485.1 të LPK-së dhe numrin tarifor 6 nga Tarifa e Avokatëve të Kosovës, ashtu që gjykata ia ka pranuar shpenzimet paditëseve në shumën 117 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi, në shumë të përgjithshme 138 € ndërsa, refuzoi shumën e kërkuar për përfaqësim në seancë pasi gjykata nuk ka mbajtur asnjë seancë për këtë çështje kontestimore (neni 398 i LPK-së). Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 e 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.
C.nr.802/2024, datë 28.03.2024

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimiit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:046170
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05521998